



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 77, datë 30.03.2022

**MBI
MIRATIMIN E PËRSHTATSHMËRISË SË SHOQËRISË “BANKA ALPHA ALBANIA”
SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572 datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 377, të Ligjit nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit” dhe Rregullores nr. 195, datë 29.12.2020 “Për licencimin e shoqërisë komisionere, regjistrimin e degës së shoqërisë së huaj komisionere dhe njohjen e shoqërisë së huaj komisionere”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

Ligji nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit”, në nenin 377, pika 1, parashikon se: *“Të gjitha subjektet e licencuara në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për titujt”, vijojnë veprimtarinë për të cilën janë licencuar, me kusht që brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të përshtaten me kërkesat e këtij ligji”.*

Për të vijuar veprimtarinë për të cilën është licencuar, banka duhet të përshtetet me kërkesat dhe kushtet e Ligjit nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit” dhe rregulloreve në zbatim të tij.

Shoqëria “Banka Alpha Albania” sh.a., aktualisht disponon licencën nr. 7 datë 25.06.2009, si “Shoqëri brokerimi në letra me vlerë të Qeverisë së RSH në bursë dhe në tregun me pakicë” dhe licencën nr. 3, datë 28.06.2010 si “Kujdestar i letrave me vlerë të Qeverisë së RSH”. Licencat janë lëshuar në bazë të Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për titujt”, i cili është shfuqizuar.

Licenca që mban “Banka Alpha Albania” sh.a., si shoqëri brokerimi, nga pikëpamja e veprimtarive të lejuara, është e njëjtë me shërbimet e investimit të përcaktuara në Ligjin e ri 62/2020:

- Marrje dhe transmetim urdhërash të klientit;
- Ekzekutim urdhërash; dhe
- Tregtim për llogari të vet.

Sipas Ligjit nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit”, shërbimi i kujdestarisë apo ruajtja dhe administrimi i instrumenteve financiare në emër të klientëve, konsiderohet shërbim ndihmës.

Me qëllim përshtatjen e veprimtarisë shoqëria “Banka Alpha Albania” sh.a., ka depozituar në Autoritet raportin e përshtatshmërisë dhe dokumentacionin, sipas kërkesave të Ligjit 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit” dhe Rregullores nr. 195, datë 29.12.2020 “Për licencimin e shoqërisë komisionere, regjistrimin e degës së shoqërisë së huaj komisionere dhe njohjen e shoqërisë së huaj komisionere”, e ndryshuar.

Për sa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e përshtatshmërisë së shoqërisë “Banka Alpha Albania” sh.a., sipas kërkesave të Ligjit 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit” dhe rregulloreve në zbatim të tij për:**
 - A. Ofrimin e shërbimeve të investimit në titujt e Qeverisë si tituj që përfshihen në kategorinë e titujve të transferueshem dhe të instrumenteve të tregut të parasë:**
 - Marrje dhe transmetim i urdhrave;
 - Ekzekutim i urdhrave në emër të klientëve; dhe
 - Tregtim për llogari të vet.
 - B. Ofrimin e shërbimit ndihmës në titujt e Qeverisë së R.SH si:**
 - Ruajtja dhe administrimi i instrumenteve financiare në emër të klientëve.
- 2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, si dhe Drejtoria e Licencimit për njoftimet dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ANËTAR

Deniz DERALLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin METE